



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERËT PUBLIKË

Nr. 375/5 prot.

Tiranë, më 30.10.2020

- Lënda:** Ankim i Komisionerit Publik kundër vendimit nr. 275, datë 20.7.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit znj. Enkeleda Osmani (Xhengo)
- Baza ligjore:** Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neni C, pika 2, neni F, pika 2 e aneksit të Kushtetutës, neni 63 i ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”
- Për kompetencë:** Kolegjit të Posaçëm të Apelit, pranë Gjykatës Kushtetuese
- Për dijëni:** Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit (ONM)
- Depozituar pranë:** Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

Të nderuar zonja/zotërinj, gjyqtarë të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, pranë Gjykatës Kushtetuese,

Në zbatim të nenit 55, pika 7 e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në RSH”, pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë, më datë 15.10.2020, është njoftuar vendimi nr. 275, datë 20.7.2020, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit znj. Enkeleda Osmani (Xhengo), me funksion prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Durrës.

Komisioneri Publik, në mbështetje të nenit C, pika 2, nenit F, pika 2 e aneksit të Kushtetutës dhe nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, ka të drejtë të ankimojë vendimin brenda afatit 15-ditor nga njoftimi.

Brenda afatit ligjor, unë, Komisioneri Publik Florian Ballhysa, ushtroj ankim ndaj vendimit nr. 275, datë 20.7.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

**I. Procesi i rivlerësimit dhe përfundimet e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit**

1. Subjekti i rivlerësimit, znj. Enkeleda Osmani (Xhengo), gjatë kryerjes së procesit të rivlerësimit nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (*në vijim, Komisioni*), ka mbajtur detyrën e prokurores në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Durrës dhe, në bazë të pikës 3, të nenit 179/b, të Kushtetutës, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit *ex officio*.

2. Në funksion të zhvillimit të procesit të rivlerësimit, Komisioni, bazuar në përcaktimet e neneve 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, ka administruar raportet e hartuara nga institucionet: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (*në vijim, ILDKPKI*); Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (*në vijim, DSIK*) dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë (*në vijim KLP*), nga të cilat rezulton se:

2.1 **ILDKPKI**, bazuar në nenin 33, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, me anë të “Aktit të përfundimit të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë për subjektin Enkeleda Osmani (Xhengo)”, ka konstatuar për subjektin se:

- (i) deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;
- (ii) dokumentacion jo i plotë ligjor për të justifikuar pasuritë;
- (iii) nuk ka kryer fshehje të pasurisë;
- (iv) nuk ka kryer deklarim të rremë;
- (v) subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

2.2 **DSIK**, bazuar në nenin 39, pika 2, të ligjit nr. 84/2016, me anë të raportit mbi kontrollin e figurës<sup>1</sup>, ka konstatuar: “Përshatshmërinë për vazhdimin e detyrës të subjektit të rivlerësimit, znj. Enkeleda \*\*\* Osmani”.

2.3 **KLP**, bazuar në nenin 43, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, nëpërmjet rishikimit të dokumenteve ligjore të përpiluara dhe të përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt rivlerësimi, si dhe rishikimit të 5 dokumenteve të tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi rastësor, duke i përcjellë Komisionit raportin e hollësishëm të vlerësimit<sup>2</sup>.

3. Bazuar në nenin Ç, pika 1 e aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 4 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, pasi ka administruar raportet e sipërcituara, kreu procesin e rivlerësimit kalimtar për subjektin në fjalë, ku fillimisht, referuar rezultateve të hetimit administrativ, ka vendosur të përfundojë hetimin vetëm për kriterin e pasurisë dhe, pasi ka vlerësuar dhe pranuar kërkesën e subjektit të rivlerësimit për riçelje të hetimit dhe për dy kriteret e tjera, e ka përfunduar procesin e rivlerësimit për subjektin znj. Enkeleda Osmani (Xhengo), bazuar në të tria kriteret e rivlerësimit.

4. Për sa më sipër, përfundimet e Komisionit për secilin kriter kontrolli, në mënyrë të përmbledhur, janë si vijon:

4.1 **Për vlerësimin e pasurisë.** Referuar nenit D, të aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, hetimi administrativ i Komisionit është shtrirë në kontrollin e saktësisë dhe mjaftueshmërisë së deklarimeve, ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurisë, ligjshmërinë e të ardhurave, shpenzimet etj., për subjektin e rivlerësimit dhe personat e lidhur me të. Komisioni, pasi ka analizuar dhe vlerësuar provat dhe faktet e dala nga hetimi administrativ, provat dhe shpjegimet e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, për të provuar të kundërtën e barrës së provës, ka arritur në përfundimin se: [...] në vlerësimin tërësor të komponentit të pasurisë, mbështetur në parimin e proporcionalitetit dhe objektivitetit, si dhe në bindjen e

<sup>1</sup> Raporti me nr. \*\*\* prot., datë \*\*\*.10.2017, i deklasifikuar plotësisht me vendim të KDZH-së nr. \*\*\*, datë \*\*\*.7.2019.

<sup>2</sup> Raporti me nr. \*\*\* prot., datë \*\*\*.6.2019.

*brendshme, çmon se subjekti i rivlerësimit me veprimet dhe mosveprimet e saj nuk ka cenuar besimin e publikut dhe ka arritur nivel të besueshëm të vlerësimit të pasurisë [...].*

**4.2 Për kontrollin e figurës.** Referuar nenit DH, të aneksit të Kushtetutës dhe nenit 39 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, në konsideratë të verifikimit dhe të konfirmimit nga institucionet përgjegjëse për përshtatshmërinë e subjektit, edhe pas hetimit administrativ, ka arritur në përfundimin se: [...] *lidhur me kriterin e pastërtisë së figurës, rezulton se subjekti i rivlerësimit, znj. Enkeleda Osmani (Xhengo), ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës [...].*

**4.3 Për vlerësimin e aftësive profesionale.** Referuar nenit E, të aneksit të Kushtetutës, nenit 43/2 dhe 44 të ligjit nr. 84/2016, si dhe kreut II të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në RSH”, të ndryshuar, Komisioni, pasi ka administruar raportin e përgatitur nga KLP, denoncimet e publikut, sipas nenit 53 të ligjit nr. 84/2016 dhe shpjegimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit, ka arritur në përfundimin se: [...] *lidhur me vlerësimin e aftësive profesionale, pas propozimit të relatores, rezultoi se subjekti i rivlerësimit është “i aftë” duke arritur nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, sipas nenit 44/a të ligjit nr. 84/2016 [...].*

**5. Vendimi i Komisionit.** Nisur nga përfundimet e mësipërme për secilin kriter kontrolli, trupi gjykues i Komisionit ka konkluduar se subjekti i rivlerësimit, znj. Enkeleda Osmani (Xhengo), ka plotësuar së bashku kushtet e parashikuara nga neni 59, pika 1, të ligjit nr. 84/2016, duke arritur një nivel të besueshëm vlerësimi për të tria kriteret, e për këto arsye, bazuar në nenin 58, pika 1, germa “a”, ka vendosur: *Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, znj. Enkeleda Osmani (Xhengo).*

5.1 Pjesë e këtij vendimi është edhe *mendimi paralel*, i një anëtareje të trupit gjykues, e cila, pasi parashtron se ka votuar për konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, ndan mendim të ndryshëm me shumicën e trupit gjykues në lidhje me ligjshmërinë e të ardhurave të deklaruara nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit nga puna, referuar nenit D, pika 3, të aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016.

## **II. Shkaqet e ankimit**

**6.** Në kuptim të nenit 179/b të Kushtetutës, aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, Komisioneri Publik është një nga tri institucionet e ngarkuara për kryerjen e procesit të rivlerësimit kalimtar (Vetting).

**7.** Bazuar në këto parashikime kushtetuese dhe ligjore, Komisionerit Publik, si përfaqësues i interesit publik në kryerjen e këtij procesi, i njihet e drejta e ankimit kundër vendimeve të Komisionit dhe paraqitjen e tyre juridiksionit kontrollues/rivlerësues të Kolegjit të Posaçëm të Apelit (në vijim, Kolegji).

**8.** Në krahasim me kompetencat e njohura për Komisionin dhe Kolegjin nga neni Ç, i aneksit të Kushtetutës dhe nenet 48-52 të ligjit nr. 84/2016, Komisioneri Publik është i detyruar që kompetencën e tij për të ushtruar ankim ndaj vendimeve të Komisionit, ta mbështesë vetëm në aktet dhe provat e administruara gjatë hetimit administrativ të kryer nga Komisioni.

**9.** Në të tilla rrethana ligjore, me qëllim garantimin e mbrojtjes së interesit publik gjatë procesit të rivlerësimit, Komisioneri Publik ka detyrimin që të ushtrojë kontroll mbi vendimet e dhëna nga Komisioni, duke vlerësuar nëse vendimmarrja e tij është në përputhje me kërkesat

kushtetuese e ligjore, bazohet në një hetim administrativ të gjithanshëm e shterues dhe vlerësim të drejtë të provave.

**10.** Në vështrim të sa më sipër, Komisioneri Publik, pasi shqyrtoi vendimin nr. 275/2020 të Komisionit, vlerëson se ai është i cenushtëm në tërësinë e tij, si dhe përmban shkaqe të mjaftueshme ligjore për t'u paraqitur për shqyrtim, nëpërmjet ankimit, juridiksionit kontrollues dhe rivlerësues të Kolegjit.

**11.** Në këto kushte, Komisioneri Publik e vlerëson të nevojshme që brenda juridiksionit rivlerësues të Kolegjit, ky i fundit, në cilësinë e organit të vetëm gjyqësor që shqyrton ankimet kundër vendimit të Komisionit, të marrë në konsideratë dhe të vlerësojë shkaqet e këtij ankimi dhe, sipas jurisprudencës të krijuar në raste të ngjashme, bazuar në nenin F, të aneksit të Kushtetutës, të kryejë vlerësimin përfundimtar të subjektit të rivlerësimit.

**12.** Komisioneri Publik vlerëson të paraqesë si shkaqe ankimi, rrethanat ligjore dhe ato të faktit, për të cilat çmon se subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur të provojë të kundërtën e barrës së provës lidhur me: (i) ekzistencën e burimeve të krijimit të të ardhurave të ligjshme, sipas përcaktimit të nenit D, paragrafi 3, të aneksit të Kushtetutës; (ii) deklarime të pasakta dhe të pamjaftueshme lidhur me posedimin dhe përdorimin e likuiditeteve *cash* ndër vite; (iii) pamjaftueshmëri financiare për të krijuar me të ardhura të ligjshme pasuritë: (a) apartament banimi, Tiranë, apartament banimi \*\*\* – Kavajë dhe një autoveturë; (iv) pamjaftueshmëri financiare për të justifikuar shpenzimet dhe kursimet për vitet 2012 dhe 2015.

**13.** Në referencë të përmbajtjes të nenit 4, pika 2, të nenit 59, pika 1, dhe nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, Komisioneri Publik çmon se gjykimi i rrethanave ligjore dhe faktike, që rezultojnë të provuara në rastin konkret, nga ana e Kolegjit është i nevojshëm me qëllim për të arritur në një vendimmarrje të Kolegjit, një vlerësim i përgjithshëm për të tria kriteret e rivlerësimit.

**14.** Në përfundim të sa më sipër, bazuar në nenin C, pika 2, nenin F, pikat 2 dhe 7, të aneksit të Kushtetutës, si dhe nenet 4 dhe 66, të ligjit nr. 84/2016, ky ankim i Komisionerit Publik ndaj vendimit nr. 275, datë 20.7.2020, të Komisionit ushtrohet për të tria kriteret e rivlerësimit.

### **III. Analiza e shkaqeve të ankimit**

#### **III.A. Kontrolli i pasurisë**

**15.** Përsa i takon rivlerësimit të kriterit të pasurisë, referuar nenit D, të aneksit të Kushtetutës dhe neneve 30-33 të ligjit nr. 84/2016, Komisioneri Publik mban në konsideratë se, gjatë kryerjes së procedurave të rivlerësimit, objekti i hetimit dhe i vlerësimit të pasurisë ndaj subjekteve që i nënshtrohen këtij procesi, sipas nenit 179/b të Kushtetutës, materializohet në kontrollin e saktësisë dhe mjaftueshmërisë së deklarimeve të subjektit (“Vetting” dhe ato periodike), ku, në çdo rast, subjekti i rivlerësimit duhet të deklarojë tërësinë e pasurisë së tij dhe shpjegojë bindshëm ligjshmërinë e burimit të krijimit të saj, si dhe ekzistencën e të ardhurave të ligjshme, sipas përkufizimit kushtetues.

**16.** **Komisioneri Publik**, përpara se të parashtrohet analiza e detajuar e shkaqeve të ankimit, çmon të nevojshme të trajtojë disa fakte dhe rrethana të konstatuara nga hetimi administrativ i Komisionit, të cilat ndikojnë në vlerësimin e ekzistencës së burimeve dhe ligjshmërisë të të ardhurave për krijimin e pasurive, për të cilat Komisioneri Publik, mbështetur dhe në jurisprudencën Kolegjit, arrin në përfundime të ndryshme nga sa argumenton Komisioni në vendimin nr. 275, datë 20.7.2020.

16.1 Kështu, gjatë hetimit administrativ të Komisionit, nuk janë administruar akte të cilat të provojnë ekzistencën e burimit të të ardhurave ose të jenë verifikuar pretendime të tjera në lidhje me ekzistencën e marrëdhënies përkatëse juridike të punësit, për periudhën e punësit pranë shoqërisë “\*\*\*.\*\*\*” sh.p.k. Rezulton, po ashtu, se është provuar që nuk janë paguar të plota detyrimet tatimore dhe sigurimet shoqërore për një pjesë të të ardhurave të deklaruara nga pagat e bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, ndërkohë, për një pjesë të tyre, detyrimet tatimore janë paguar gjatë procesit të rivlerësimit.

16.2 Nisur nga këto rrethana, gjatë hetimit të Komisionit, duke qenë se subjekti i rivlerësimit ka rezultuar në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme dhe pamjaftueshmërisë së të ardhurave, ajo ka pretenduar, po ashtu, se deklarimi dhe përdorimi i kursimeve në *cash* në krijimin e pasurisë, duhet konsideruar sikurse është deklaruar nga subjekti gjatë hetimit administrativ dhe jo bazuar në deklaratat periodike vjetore.

16.3 Për këto situata faktike të provuara, Komisioni, pasi ka administruar provat dhe shpjegimet e subjektit të rivlerësimit pas kalimit të barrës së provës, ndër të tjera, për të ardhurat e deklaruara nga punësi pranë shoqërisë “\*\*\*.\*\*\*” sh.p.k., ka arsyetuar se: [...] *Lidhur me ligjshmërinë e marrëdhënies së punës, trupi gjykues, duke vlerësuar faktet se: (i) subjekti ka deklaruar të ardhurat për bashkëshortin në kohë reale; (ii) punëdhënësi dëshmoi përpara trupit gjykues se marrëdhënia e punësit të bashkëshortit të subjektit ka vijuar prej vitit 2002 – 2008; (iii) pagesat e përfituara prej tij janë bërë përmes çeqeve, si një nga mënyrat e parashikuara në nenin 118 të Kodit të Punës (referuar legjislacionit në kohën që ka ndodhur veprimi); (iv) janë derdhur kontributet nga punëdhënësi në favor të punëmarrësit, pavarësisht se vetëm për pagën minimale, por që shërbejnë si indicie për të treguar se marrëdhënia e punësit ka funksionuar; (v) legjislacioni i kohës lejonte mënyrën e pagimit të pagës, sipas parashikimeve kontraktore dhe nuk bënte me përgjegjësi punëmarrësin, ka vlerësuar se subjekti ka shpjeguar bindshëm marrëdhënien e punësit me këtë shoqëri. Bazuar në sa më sipër arsyetuar, Komisioni, në përfundim për këtë çështje, ka vlerësuar të aplikojë parimin e objektivitetit që lidhet me pamundësinë e subjektit për të provuar marrjen dijeni të mospagimit të detyrimeve në favor të tij. Në këtë kontekst, rrethanat faktike dhe ligjore diktojnë që proporcionalisht nuk gjendemi përpara arsyeve të mjaftueshme për të aplikuar ndonjë masë disiplinore të parashikuara në nenin 61 të ligjit nr. 84/2016 [...].<sup>3</sup>*

16.4 Bazuar në arsyetimin e mësipërm, Komisioni i ka konsideruar si të ardhura të ligjshme, shumat e deklaruara të përfituara nga punësi i bashkëshortit të subjektit pranë shoqërisë “\*\*\*.\*\*\*” sh.p.k. Ndërkohë, Komisioneri Publik konstaton se provueshmëria e ekzistencës së burimit të ligjshëm dhe ligjshmërisë të të ardhurave të përfituara nga marrëdhëniet e punës së bashkëshortit të subjektit, është në nivel deklarativ, sikundër do të trajtohet më gjerësisht në vijim.

**17. Komisioneri Publik** e gjen të pabazuar vlerësimin e Komisionit, që i ka konsideruar si të ardhura të ligjshme në kuptim të ligjit, të gjithë shumën e të ardhurave të deklaruara nga subjekti në deklaratat periodike vjetore, si të ardhura nga punësi i bashkëshortit të saj pranë shoqërisë “\*\*\*.\*\*\*” sh.p.k. Në këtë drejtim, Komisioneri Publik sjell në vëmendje jurisprudencën e Kolegjit, i cili ka trajtuar në mënyrë shteruese elemente të lidhura me: (i) rëndësinë që përbën provueshmëria me dokumentacion e pretendimeve të ngritura nga

---

<sup>3</sup>Faqe 33, e vendimit të Komisionit.

subjektet në procesin e vlerësimit të kriterit pasuror; (ii) interpretimin e përmbajtjes së dispozitës së pikës 3, të nenit D, të aneksit të Kushtetutës dhe nenit 30 të ligjit nr. 84/2016, për përcaktimin dhe provueshmërinë e ligjshmërisë së të ardhurave; si dhe (iii) rastet kur gjatë procedurës të rivlerësimit, me qëllim legjitimimin e të ardhurave është kryer *a posteriori* pagesa e detyrimeve tatimore të papaguara.

17.1 Përsa i takon rëndësisë që ka provueshmëria me dokumentacion e pretendimeve të ngritura nga subjektet, Kolegji, nëpërmjet jurisprudencës së tij, në vendimin (JR) nr. 5/2020, prg. 41.4, ka nënvizuar faktin se saktësia e pretendimeve të subjekteve gjatë vlerësimit të kontrollit të pasurisë duhet të provohet me dokumentacion shoqërues dhe jo të mbetet në nivel deklarativ.

17.2 Ndërkohë, për përcaktimin dhe provueshmërinë e ligjshmërisë së të ardhurave, të krijuara nga burime të ligjshme, në lidhje me interpretimin e përmbajtjes së dispozitës së pikës 3, të nenit D, të aneksit të Kushtetutës dhe nenit 30 të ligjit nr. 84/2016, Komisioneri Publik në qëndrimin e tij, ndër të tjera, i referohet dhe arsytimit të Kolegjit në vendimin e Kolegjit (JR) nr. 7/2019, prg. 24, në të cilin, specifikisht për të ardhurat e realizuara nga personi i lidhur i subjektit të rivlerësimit si i punësuar, është argumentuar se ato duhet të llogariten për aq sa janë deklaruar në organet tatimore dhe jo sa janë deklaruar nga subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur, në deklaratimet periodike vjetore. Si rrjedhojë, interpretimi i kësaj dispozite, bazuar dhe në jurisprudencën e Kolegjit, për përcaktimin e ligjshmërisë së të ardhurave, kërkon që të ardhurat: (i) të jenë krijuar nga burime të ligjshme; (ii) të jenë deklaruar dhe (iii) për to të jenë paguar detyrimet tatimore përkatëse<sup>4</sup>.

17.3 Lidhur me rastet kur pagesa e detyrimeve tatimore është kryer pas dorëzimit të Deklaratës “Vetting” 2017, gjatë procedurës të rivlerësimit, me qëllim legjitimimin e të ardhurave, Komisioneri Publik sjell në vëmendje se në jurisprudencën e Kolegjit ka gjetur interpretim, edhe në këtë rast, ekzistenca ose jo e ligjshmërisë së këtyre të ardhurave, referuar këtu vendimeve (JR) nr. 8/2019; nr. 31/2019; nr. 5/2020 dhe nr. 15/2020 të Kolegjit.

17.4 Përsa i përket pretendimit të subjektit të rivlerësimit, gjatë hetimit administrativ të Komisionit, mbi përdorimin e kursimeve në *cash*, ndryshe nga sa rezulton në deklaratat periodike vjetore, Komisioneri Publik sjell në vëmendje, ndër të tjera<sup>5</sup>, vendimin e Kolegjit (JR) nr. 7/2019, prg. 39, i cili, për zgjidhjen e çështjeve të ngjashme në të ardhmen, ka orientuar Komisionin që: [...] *të mos prezumojë përdorimin nga subjektet të gjendjeve cash si burime për krijimin e pasurive dhe mbulimin e shpenzimeve, për sa kohë një gjë e tillë nuk është deklaruar në mënyrë të qartë dhe të plotë nga vetë subjekti i rivlerësimit në deklaratat periodike [...].*

17.5 Referuar sa më lart, bazuar në përcaktimin e nenit D, pika 3, të aneksit të Kushtetutës, nenit 30 të ligjit nr. 84/2016, si dhe jurisprudencës së Kolegjit, Komisioneri Publik vlerëson se të ardhurat, të cilat nuk plotësojnë kushtet e kërkuara nga këto dispozita ligjore, nuk mund konsiderohen si të ardhura të ligjshme, të krijuara nga burime të ligjshme, për qëllim të procesit të rivlerësimit, dhe për pasojë ato nuk mund të konsiderohen në analizën mbi mundësinë

<sup>4</sup>Referohuni vendimeve (JR) nr. 3/2018, prg. 24; nr. 7/2018, prg. 52; nr. 6/2019, prg. 21.12; nr. 19/2019, prg. 22.13 dhe nr. 32/2019, prg. 56.

<sup>5</sup>Për më tepër referohuni vendimeve (JR) nr. 11/2019, pika 27.12.18 e prg. 27; nr. 19/2019, prg. 84; nr. 20/2019, prg. 59 etj.

financiare për krijimin e pasurive nga ana e subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur me të.

17.6 Komisioneri Publik, në referencë të kriterëve të përcaktuara në nenin D, pika 3 e aneksit të Kushtetutës, që kanë gjetur interpretim nga jurisprudenca e Kolegjit, kërkon në rastin konkret shqyrtimin gjyqësor të këtyre çështjeve: (i) vlerësimin e mundësive financiare të subjektit për krijimin me të ardhura të ligjshme të pasurisë apartament banimi, me sip. 111.87 m<sup>2</sup>, ndodhur në Tiranë; (ii) vlerësimin e mundësive financiare të subjektit për krijimin me të ardhura të ligjshme e pasurive apartament banimi, \*\*\* – Kavajë, me sip. 45.6 m<sup>2</sup> dhe autoveturë “Audi”; (iii) vlerësimin e mundësisë financiare për të justifikuar me të ardhura të ligjshme shpenzimet dhe kursimet për vitet 2012 dhe 2015, si më poshtë analizuar.

**18. Për pasurinë apartament banimi, me sip. 111.87 m<sup>2</sup>, ndodhur në \*\*\*, Tiranë.**

18.1 Në Deklaratën “Vetting”, subjekti ka deklaruar: Apartament banimi, me sip. 111.87 m<sup>2</sup>, ndodhur në \*\*\*, Tiranë. Vlera: 50.341 euro. Pjesa takuese: 50 %. Blerë me kontratën e sipërmarrjes (porosisë) nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë \*\*\*.11.2006, nga shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k. *Burimi i krijimit:* (i) kursime nga të ardhurat nga paga; (ii) hua në shumën 10.000 euro nga prindërit e bashkëshortit, \*\*\* dhe \*\*\*.\*\*\*; si dhe (iii) shuma 6.000 euro, dhuratë nga motra e bashkëshortit të subjektit, znj. \*\*\*.\*\*\*.

18.2 Në DV-2006, subjekti ka deklaruar: Apartament me sip. 112 m<sup>2</sup>, porositur sipas kontratës së porosisë nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë \*\*\*.11.2006, me vlerë totale 50.000 euro, paguar shuma 25.000 euro.

18.3 Në DV-2007, subjekti ka deklaruar: Pagesë të kryer në muajin dhjetor ndaj shoqërisë “\*\*\*\*”, në shumën 10.000 euro, sipas kontratës së porosisë nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë \*\*\*.11.2006.

18.4 Në DV-2008, subjekti ka deklaruar: Pagesë ndaj shoqërisë “\*\*\*\*”, në shumën 8.000 euro.

18.5 Në DV-2009, subjekti ka deklaruar: Pagesë ndaj shoqërisë “\*\*\*\*”, në shumën 7.000 euro.

18.6 Referuar shkresave të ASHK-së me nr. \*\*\* prot., datë \*\*\*.6.2019 dhe ajo me nr. \*\*\* prot., datë \*\*\*.7.2019, rezulton se kjo pasuri e porositur me anë të kontratës së sipërmarrjes me nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë \*\*\*.11.2006, ende nuk është regjistruar në emër të subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur me të, bashkëshortit të saj.

18.7 Nga hetimi administrativ i Komisionit<sup>6</sup>, ka rezultuar se pagesat për këtë pasuri janë kryer si vijon:

- 25.000 euro paguar në datën \*\*\*.11.2006, me nënshkrimin e kontratës;
- 10.000 euro paguar në datën \*\*\*.12.2007, sipas mandatarkëtimit në arkën e shoqërisë;
- 3.000 euro paguar në datën \*\*\*.7.2008, në llogarinë e shoqërisë, në \*\*\* Bank;
- 5.000 euro paguar në datën \*\*\*.12.2008, sipas mandatarkëtimit në arkën e shoqërisë;
- 7.000 euro paguar në datën \*\*\*.11.2009, sipas mandatarkëtimit në arkën e shoqërisë.

---

<sup>6</sup> Për më tepër referohuni në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga subjekti gjatë përgjigjeve të pyetësorit nr. 2, datë 2.4.2019, dokumentacionit të depozituar në dosjen e Komisionit dhe korrespondencës me shoqërinë “\*\*\*\*” sh.p.k.

18.8 Lidhur me burimin e deklaruar: *kursime nga pagat*, nga hetimi administrativ i Komisionit, ka rezultuar se:

(i) Për vitet 2006 – 2009 (periudhë gjatë së cilës është likuiduar pasuria), subjekti ka deklaruar në deklaratat periodike vjetore, përveç të ardhurave të saj si prokurore dhe të ardhurat e bashkëshortit si i punësuar pranë katër shoqërive tregtare<sup>7</sup>, të ardhurat e të cilit janë në total në shumën 5.200.000 lekë.

(ii) Për punësimin e bashkëshortit të subjektit, nga korrespondenca e Komisionit me ISSH-në, Arkivin Qendror dhe Drejtoritë Rajonale, ka rezultuar se bashkëshorti ose nuk figuron në listëpagesat e shoqërive të deklaruara, ose është siguruar për një pagë më të vogël nga ajo e deklaruar në deklaratimet periodike vjetore nga subjekti apo në vërtetimet e punës së depozituar në ILDKPKI<sup>8</sup>.

18.9 Për sa më sipër, për këtë periudhë, nga institucionet shtetërore konfirmohet vetëm pagesa e detyrimeve tatimore për punësimin e bashkëshortit të subjektit pranë shoqërisë “\*\*\*.\*\*\*” sh.p.k., për të ardhurat, respektivisht, në shumën 106.072 lekë për vitin 2005; 119.042 lekë për vitin 2006 dhe 86.333 lekë për vitin 2007<sup>9</sup>.

18.10 Ndërkohë, gjatë hetimit administrativ, në lidhje me punëdhënësin “\*\*\*.\*\*\*” sh.p.k., subjekti ka depozituar një vërtetim (pa datë), lëshuar nga administratori i kësaj shoqërie, tashmë me status “shoqëri në likuidim e sipër”, ku, ndër të tjera, deklarohet se: [...] z. \*\*\*.\*\*\* ka punuar pranë shoqërisë sonë, me profesion inxhinier ndërtimi, nga periudha korrik 2002 deri në gusht 2008 dhe se është angazhuar me kohë të plotë me detyra të ndryshme, me pagë mujore 80.000 lekë [...].

18.11 Sipas të dhënave nga ISSH-ja rezulton se punëdhënësi “\*\*\*.\*\*\*” sh.p.k. ka paguar detyrime tatimore për punëmarrësin, bashkëshortin e subjektit të rivlerësimit gjatë viteve 2003 – 2007 (me shkëputje), për paga bruto që variojnë nga 9.403 lekë deri në 48.611 lekë, shuma të cilat nuk përputhen me pagën mujore të deklaruar prej 80.000 lekësh, pasqyruar dhe në vërtetimin e lëshuar nga kjo shoqëri për efekt të procesit të rivlerësimit. Bazuar në këtë akt, të ardhurat neto për vitet 2005 – 2007 rezultojnë në shumën 311.446 lekë. Gjithashtu rezulton se nuk konfirmohet që këto pagesa të kenë kaluar nëpërmjet sistemit bankar apo me një nga mënyrat e parashikuara nga legjislacioni në fuqi.

18.12 Përsa i përket punëdhënësve, shoqëritë “\*\*\*” sh.p.k. dhe “\*\*\*.\*\*\*” sh.p.k., nga hetimi administrativ, ka rezultuar se subjekti ka depozituar kontratat respektive të punës, por nuk konfirmohet që për periudhën në fjalë të jenë paguar detyrimet tatimore dhe sigurimet shoqërorë dhe as kalimi i pagave nëpërmjet sistemit bankar apo ndonjë formë tjetër të parashikuar nga ligji.

18.13 Në këto kushte, lidhur me ligjshmërinë e të ardhurave që kanë shërbyer për të krijuar pasurinë: *apartment me sip. 111.87 m<sup>2</sup>*, për periudhën nga viti 2006 (kur është paguar kësti i parë) deri në vitin 2009 (kur është paguar kësti i fundit), fillimisht Komisioni ka vlerësuar se:

<sup>7</sup>Subjekti ka deklaruar se bashkëshorti ka siguruar të ardhura nga punësimi pranë “\*\*\*.\*\*\*” sh.p.k., në vlerën totale 2.560.000 lekë; “\*\*\*” sh.p.k., në vlerën totale 990.000 lekë; “\*\*\*.\*\*\*”, person fizik., në vlerën totale 1.400.000 lekë dhe “\*\*\*.\*\*\*” sh.p.k., në vlerën totale prej 250.000 lekë.

<sup>8</sup> Komisioni ka kërkuar informacion edhe nga 4 shoqëritë punëdhënëse (duke iu drejtuar në adresat e pasqyruara në QKB), për të cilat ka administruar kthimin e kërkesës me postë me shënimet, përkatësisht: “objekt i pakërkuar”, “adresë e pamjaftueshme”, “i panjohur” dhe “adresë e pasaktë”.

<sup>9</sup>Referohuni konfirmimit nga Drejtoria e Arkivit Qendror, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë \*\*\*.9.2019.



[...] (i) subjekti nuk ka pasur mundësi financiare në shumën prej - 3.349.875 lekësh për të investuar në këtë pasuri, si dhe për të kryer shpenzimet e tjera familjare; (ii) ka mospërputhje të deklaramit të subjektit në vitet 2006 – 2009, për të ardhurat e përfituara nga punësimi i bashkëshortit, sipas dokumentacionit të lëshuar nga subjektet tregtare “\*\*\*.\*\*\*” sh.p.k., “\*\*\*” sh.p.k., “\*\*\*.\*\*\*” dhe “\*\*\*.\*\*\*” sh.p.k., krahasuar me informacionin dhe dokumentacionin e depozituar nga ISSH [...], si rrjedhojë subjektit të rivlerësimit i ka kaluar barra e provës për të provuar të kundërtën.

18.14 Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të barrës së provës, lidhur me të ardhurat nga punësimi i bashkëshortit të saj, ndër të tjera, ka paraqitur prova dhe parashtruar se:

18.14.1 Për marrëdhënien e punësimit me shoqërinë “\*\*\*.\*\*\*” sh.p.k., subjekti ka deklaruar se bashkëshorti ka filluar punë në korrik të vitit 2002, duke dhënë detaje rreth detyrave funksionale të kryera prej tij dhe duke renditur objektet e ndërtuara ku bashkëshorti ka ushtruar detyrën<sup>10</sup>.

18.14.2 Lidhur me situatën faktike të konstatuar nga hetimi administrativ se, për të ardhurat e deklaruara të përfituara nga punësimi i bashkëshortit në shoqërinë “\*\*\*.\*\*\*” sh.p.k., ishin paguar detyrimet tatimore mbi bazën e pagës minimale, ndër të tjera, subjekti i rivlerësimit ka parashtruar se nuk ka pasur dijeni.

18.14.3 Për shkak se shoqëria “\*\*\*.\*\*\*” sh.p.k. është me status “shoqëri në likuidim e sipër”, ish-administratori dhe ortak i shoqërisë, z. \*\*\*.\*\*\*, ka marrë përsipër pagimin e detyrimit tatimor, duke rimbursuar shumën në llogarinë personale të bashkëshortit, pasi ky i fundit i ka paguar ato pranë organeve tatimore. Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se e vetmja mundësi ligjore ishte deklarimi në formularin DIVA për vitin më të hershëm të deklaramit - viti 2011, duke paguar jo vetëm *principalin* e detyrimit për tatimin mbi të ardhurat, por dhe të gjitha penalitetet dhe kamatëvonesat për pagesën me vonesë të këtij detyrimi tatimor, duke depozituar dhe dokumentacionin përkatës.

18.15 Ndërkohë, lidhur me problematikat e konstatuara rreth marrëdhënies së punësimit të bashkëshortit në dy kompanitë e tjera, përkatësisht “\*\*\*” sh.p.k. dhe “\*\*\*.\*\*\*” sh.p.k., subjekti i rivlerësimit ka parashtruar se ka depozituar paditë përkatëse kundër tyre, me objekt: detyrimin për të paguar kontributet e papaguara në favor të palës paditëse/punëmarrësit (bashkëshortit të saj).

18.16 Komisioni, në analizë të provave dhe prapësimeve të paraqitura nga subjekti, ndër të tjera, ka arsyetuar se: [...] *se për këtë çështje duhet aplikuar parimi i objektivitetit që lidhet me pamundësinë e subjektit për të provuar marrjen dijeni të mospagimit të detyrimeve në favor të tij. Në këtë kontekst, rrethanat faktike dhe ligjore diktojnë që, proporcionalisht, nuk gjendemi përpara arsyeve të mjaftueshme për të aplikuar ndonjë masë disiplinore të parashikuar në nenin 61 të ligjit nr. 84/2016*<sup>11</sup>[...].

18.17 Në përfundim për sa më sipër, rezulton se Komisioni i ka konsideruar si të ardhura të ligjshme, shumat e deklaruara të përfituara nga punësimi i bashkëshortit pranë shoqërisë “\*\*\*.\*\*\*” sh.p.k., duke pranuar parashtrimet e subjektit të rivlerësimit dhe provat e paraqitura prej tij, si të mjaftueshme në zbatimin e përcaktimeve të nenit D, pika 3, të aneksit të

<sup>10</sup> Për më tepër, referohuni shpjegimeve të subjektit për rezultatet e hetimit.

<sup>11</sup>Referohuni më gjerësisht f. 30 - 33, të vendimit, analiza e provave dhe fakteve në raport me ligjin e zbatueshëm.

Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, duke konkluduar se subjekti: [...] *ka kryer deklaram të saktë dhe ka shpjeguar bindshëm burimin e krijimit të kësaj pasurie dhe subjekti ka burime financiare të ligjshme për krijimin e saj për vitet 2006 – 2009, pavarësisht balancës negative prej 143.348 lekësh, të rezultuar në vitin 2008, vlerë kjo që, nëse do të përfshiheshin të ardhurat nga punësimi në shoqëritë për të cilat është ngritur padi gjyqësore, subjekti do të gjendej në balancë pozitive [...].*

**19. Komisioneri Publik**, në analizë të rrethanave juridike të provuara dhe situatës faktike të konstatuar si më sipër, për pasurinë apartament banimi me sip. 111.87 m<sup>2</sup>, ndodhur në Tiranë, vlerëson se përfundimet e arritura nga Komisioni nuk janë të bazuara në prova, në ligjin e zbatueshëm, si dhe jurisprudencën e lartpërmendur të Kolegjit, pasi:

19.1 Rezulton e provuar se në lidhje me të ardhurat e përfituara nga shoqëria “\*\*\*.\*\*\*” sh.p.k., subjekti i rivlerësimit, në DV-2006 deri në DV-2008, ka deklaruar të ardhura vjetore në shumën totale 2.560.000 lekë. Në këtë marrëdhënie punësimi: (i) nuk provohet që të jetë e rregulluar me një kontratë midis palëve; (ii) vlera e deklaruar e pagës nuk rezulton të ketë kaluar nëpërmjet sistemit bankar; (iii) dhe për vitet 2006-2008, subjekti nuk rezulton të ketë provuar marrjen e shumave të deklaruara në asnjë nga mënyrat e përcaktuara në legjislacionin në fuqi.

19.2 ISSH-ja, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë \*\*\*.9.2019, konfirmon se subjekti “\*\*\*.\*\*\*” sh.p.k., për periudhën janar 2003 – nëntor 2006, ka deklaruar të ardhura mbi bazën e të cilave është derdhur kontributi pranë këtij institucioni për shumën e të ardhurave neto në masën 311.447 lekë.

19.3 Fakti i mospagimit të detyrimeve tatimore, në kohë dhe sipas shumave të deklaruara, konfirmohet edhe nga deklarimi i ish-administratorit dhe ortakut të shoqërisë, shtetasi \*\*\*.\*\*\*, i thirrur në cilësinë e dëshmitarit nga ana e Komisionit, i cili ka deklaruar se ka depozituar në datën \*\*\*.11.2019, gjatë procesit të rivlerësimit, në llogarinë e bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, shumën prej 444.624 lekë, shumë kjo e përdorur nga bashkëshorti i subjektit për të paguar detyrimet tatimore, të llogaritura sipas DIVA 2011.

19.4 Duke u bazuar në përcaktimet e ligjit nr. 84/2016, nenit D, pika 3 e aneksit të Kushtetutës dhe praktikës së Kolegjit, të ardhura të ligjshme për qëllim të procesit të rivlerësimit do të konsiderohen vetëm ato të ardhura për të cilat, në mënyrë kumulative, provohet se: (i) janë krijuar nga burime të ligjshme; (ii) janë deklaruar dhe (iii) për to janë paguar detyrimet përkatëse.

19.5 Për sa më sipër, Komisioneri Publik vlerëson se të ardhurat e ligjshme nga punësimi i personit të lidhur, bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, në shoqërinë “\*\*\*.\*\*\*” sh.p.k., do të duhej të konsideroheshin vetëm të ardhurat neto, të konfirmuara nga institucionet shtetërore. Duke marrë për bazë këtë, nga analiza financiare për vitet 2006, 2007 dhe 2008, rezulton se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të, nuk mbulojnë me të ardhura të ligjshme, në kuptim të nenit D, pika 3 e aneksit të Kushtetutës, shpenzimet dhe investimet e kryera për një diferencë negative prej - 2.389.419 lekë<sup>12</sup>.

---

<sup>12</sup> Në këtë analizë janë marrë në konsideratë të ardhurat neto të subjektit sipas vërtetimit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës, datë \*\*\*.1.2017 dhe Universitetit “A. Moisiu”, Durrës, si dhe të ardhurat neto të bashkëshortit nga punëdhënësi “\*\*\*.\*\*\*” sh.p.k., bazuar në shkresën e ISSH-së, me nr. \*\*\* prot., datë \*\*\*.9.2019, dhe punëdhënësi “\*\*\*.\*\*\*”, bazuar në shkresën e Drejtorisë Rajonale Tatimore, Tiranë, me nr. \*\*\* prot., datë \*\*\*.11.2019, huatë dhe dhurimet e deklaruara

**20.** Për pasurinë: *apartament banimi me sip. 45.6 m<sup>2</sup>, i ndodhur në \*\*\* – Kavajë dhe pasurinë autoveturë “Audi”*

20.1 Në Deklaratën “Vetting”, subjekti i rivlerësimit, znj. Osmani (Xhengo), ka deklaruar: Apartament banimi, \*\*\* - Kavajë, me sipërfaqe 45.6 m<sup>2</sup>. Blerë me kontratën e shitblerjes nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë \*\*\*.4.2011, nga shtetasi \*\*\*.\*\*\*. Burimi i krijimit: *kursime nga të ardhurat nga pagat*. Vlera: 1.837.305 lekë. Pjesa takuese: 50%.

20.2 Në DV-2011, subjekti ka deklaruar: *apartament në \*\*\*-Kavajë, me sipërfaqe 45.6 m<sup>2</sup>, në vlerën 1.837.305 lekë*. Burim krijimi për këtë pasuri është deklaruar: *kursime nga të ardhurat nga pagat* (plotësuar me shkrim dore burimi). Pjesa takuese: ½.

20.3 Origjina e kësaj pasurie vjen nga kontrata e shitblerjes me nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë \*\*\*.4.2011, me palë shitëse \*\*\*.\*\*\* dhe palë blerëse \*\*\*.\*\*\*. Vlera e apartamentit është 1.837.305 lekë, shumë e cila është likuiduar jashtë zyrës noteriale. ASHK, Drejtoria Vendore Kavajë e konfirmon këtë pasuri të regjistruar në emër të shtetasit \*\*\*.\*\*\*, bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit.

20.4 Komisioni ka kryer analizën mbi mundësinë financiare të subjektit për të investuar në këtë pasuri, duke u bazuar në të ardhurat e konfirmuara nga institucionet përkatëse. Nga kjo analizë financiare, fillimisht, Komisioni ka konstatuar, se: (i) dukej se subjekti nuk kishte pasur mundësi financiare në shumën - 1.603.951 lekë, sipas deklarimeve të kryera në deklaratat periodike vjetore, për të investuar në blerjen e kësaj pasurie; (ii) dukej se kishte mospërputhje të deklaramit të subjektit në vitin 2011, në lidhje me të ardhurat e përfituara nga bashkëshorti, referuar dokumentacionit të lëshuar nga shoqëritë “\*\*\*.\*\*\*”, person fizik dhe “\*\*\*.\*\*\*” sh.p.k., ku kishte punuar, krahasuar me informacionin dhe dokumentacionin e depozituar nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore dhe, për pasojë, subjektit i është kaluar barra e provës për të provuar të kundërtën.

20.5 Në lidhje me të ardhurat nga punësimi pranë shoqërisë “\*\*\*.\*\*\*”, person fizik, subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të rezultateve të hetimit, ka deklaruar se të ardhurat kanë ardhur nga kryerja e shërbimit të realizuar nga bashkëshorti në subjektin “\*\*\*.\*\*\*”/Person Fizik, me NIPT \*\*\*, si inxhinier projektues, duke depozituar në Komision shkresën e Drejtorisë Rajonale Tatimore, Tiranë me nr. \*\*\* prot., datë \*\*\*.11.2019, duke provuar se sipas kësaj shkrese rezulton se prej personit fizik “\*\*\*.\*\*\*” është paguar tatim në burim për bashkëshortin e saj, z. \*\*\*.\*\*\*. Subjekti, gjithashtu, ka pretenduar se, krahas pagës mujore, në janar të vitit 2011, bashkëshorti i saj ka përfituar dhe shumën prej 300.000 lekësh si shpërblim.

20.6 Në lidhje me të ardhurat nga punësimi pranë shoqërisë “\*\*\*.\*\*\*” sh.p.k., subjekti ka parashtruar se ka rënë në dijeni të faktit të mospagimit të detyrimeve tatimore dhe kontributeve sipas shumës së deklaruar, vetëm nga zhvillimi i procesit të rivlerësimit, si dhe, me të rënë në dijeni të këtij fakti, ka vënë në lëvizje gjykatën me kërkesë padi, me objekt: detyrimin e punëdhënësit të paguajë kontributet sipas legjislacionit dhe parashikimeve kontraktuale, duke depozituar, për këtë qëllim, padinë dhe vërtetimin e lëshuar nga gjykata mbi regjistrimin e saj.

20.7 Ndërsa për sa i përket analizës financiare të kryer nga Komisioni, subjekti ka kontestuar mospërfshirjen e shumës 1.000.000 lekë, si gjendje kursime në *cash*, e deklaruar në DV-2010

---

dhe të provuara; shpenzimet e jetesës sipas përbërjes familjare, bazuar në të dhënat INSTAT, shpenzimet e udhëtimit sipas të dhënave të sistemit TIMS dhe ndryshimet e likuiditeteve në llogaritë bankare.

dhe, për rrjedhojë, të mbartur dhe të përdorur në vitin 2011. Subjekti ka pretenduar se në këtë pasuri, përgjithësisht, janë investuar kursimet nga të ardhurat nga pagat e tyre dhe, në këtë kontekst, ka kërkuar përfshirjen e kursimeve në *cash* të vitit 2010 në blerjen e saj.

20.8 Pas vlerësimit të provave dhe parashtrimeve të subjektit të rivlerësimit për të provuar të kundërtën e barrës së provës, Komisioni ka konkluduar se: [...] *Nisur nga fakti që u provua ligjshmëria e të ardhurave të bashkëshortit të subjektit, të siguruara për vitet 2008 – 2012, nga punësimi në shoqërinë “\*\*\*.\*\*\*”, provohet edhe mundësia e krijimit të gjendjes cash një vit më parë. Në këto kushte, trupi gjykues e gjen me vend logjikën e përdorur nga subjekti se, për sa kohë është provuar se shuma 1.000.000 lekë ka qenë e mundur të kursehet nga bashkëshortët, kjo shumë, lehtësisht, mund të jetë investuar në blerjen e kësaj pasurie, duke qenë se në çdo rrethanë bie në sy fakti që si burim krijimi janë përdorur vetëm të ardhura të realizuara nga pagat e bashkëshortëve dhe, në këtë drejtim, blerja e pasurisë në muajin prill 2011 pranon përfshirjen e kursimeve të fillimvitit dhe të atyre të mbartura nga një vit më parë. Nën këtë analizë logjiko - juridike, por edhe matematikore, trupi gjykues çmon se subjekti ka shpjeguar bindshëm burimin e krijimit të kësaj pasurie [...] <sup>13</sup>.*

20.9 Nisur nga sa më sipër, Komisionit, nga analiza financiare deri në datën 11.4.2011, duke përfshirë të ardhurat nga paga nga dy punëdhënësit, shumën shtesë prej 400.000 lekë, si dhe gjendjen *cash* në shumën 1.000.000 lekë, i ka rezultuar se subjekti: (i) ka shpjeguar bindshëm dhe ka faktuar me prova burimin e krijimit të shumës 5.125.734 lekë, shumë e krijuar nga të ardhurat e përfituara nga punësimi i bashkëshortit në shoqërinë “\*\*\*.\*\*\*”, person fizik; (ii) ka bërë deklaram të mjaftueshëm në lidhje me burimin e krijimit të kësaj pasurie, në përputhje me pikën 3, të nenit D, të Kushtetutës, dhe se (iii) rezulton në balancë pozitive për krijimin e kësaj pasurie.

20.10 Bazuar në aktet e administruara dhe rezultatet e hetimit administrativ, rezulton, gjithashtu, se subjekti i rivlerësimit, në D. Vett., sikundër dhe në DV-2011, ka deklaruar edhe pasurinë *Automjet tip “Audi A2”, viti i prodhimit 2001, me targa AA\*\*\*, blerë nga shtetasi \*\*\*.\*\*\*, me kontratën e shitblerjes nr.\*\*\* rep., nr.\*\*\* kol., datë \*\*\*.4.2011. Vlera 3.000 euro. Burimi i krijimit: Të ardhura nga puna. Pjesa takuese 100%. Kjo pasuri është blerë 5 ditë më pas nga blerja e pasurisë apartament banimi me sip. 45.6 m<sup>2</sup>, i ndodhur në \*\*\* – Kavajë. Në këto kushte, kur rezultoi se këto dy pasuri janë blerë afër në kohë dhe nuk ka pasur asnjë ndryshim në të ardhurat familjare, Komisioni i ka kërkuar shpjegime subjektit të rivlerësimit, pasi dukej se nuk kishte pasur mundësi financiare për të justifikuar blerjen e automjetit në shumën 3.000 euro.*

20.11 Subjekti, në përgjigje të rezultateve të hetimit, ndër të tjera, ka deklaruar se bashkëshorti, në datën 13.4.2011, ka marrë nga punëdhënësi “\*\*\*.\*\*\*”, person fizik, edhe shumën prej 500.000 lekë, në formën e paradhënies së pagave për periudhën prill - gusht 2011, duke vënë në dispozicion të Komisionit një dokument: *pasqyrë e llogarisë personale*, të datës 13.4.2011, ku pasqyrohet fakti se punëdhënësi i ka dhënë parapagim në lidhje me shërbimet që do të kryente bashkëshorti i subjektit, shumën prej 500.000 lekë. Edhe në këtë rast, Komisioni i ka pranuar pretendimet dhe provat e subjektit, duke çmuar se subjekti ka kryer deklaram të mjaftueshëm lidhur me këtë pasuri (automjetin) dhe ka pasur të ardhura të ligjshme për krijimin e saj.

---

<sup>13</sup> Faqe 17 e vendimit.

**21. Komisioneri Publik**, në analizë të rrethanave dhe situatës faktike të konstatuar si më sipër, vlerëson se konkluzionete arritura nga Komisioni lidhur me këto dy pasuri nuk janë të bazuara në prova, në ligjin e zbatueshëm, si dhe jurisprudencën e lartpërmendur të Kolegjit.

21.1 Në vlerësimin e Komisionerit Publik mbetet i pabazuar pretendimi i subjektit mbi përdorimin e kursimeve në *cash* të deklaruara në DV-2010, si burim për krijimin e pasurive dhe në mbulimin e shpenzimeve deri në datën 16.4.2011, për sa kohë që ky deklaram nuk është bërë në DV-2011. Deklarimet e subjektit gjatë hetimit administrativ mbi posedimin dhe ndryshimin e likuiditeve në *cash*, për periudhën 2011-2016, nuk përputhen me deklaramet e vetë subjektit në deklaramat periodike vjetore, të cilat, bazuar në nenin 32, pika 5 të ligjit nr. 84/2016 dhe në praktikën e Kolegjit, konsiderohen si provë<sup>14</sup>. Duke qenë se kursimet në *cash* gjenden jashtë sistemit bankar dhe e vetmja mënyrë verifikimi janë deklaramet e subjektit në deklaramat periodike vjetore, në vlerësimin e Komisionerit Publik, shpjegimet e subjektit gjatë hetimit administrativ për përdorimin e tyre mbeten në nivel deklarativ.

21.2 Bazuar në sa më sipër, nga analiza financiare, lidhur me këto pasuri, rezulton se subjekti nuk provoi të kundërtën e barrës së provës dhe, rrjedhimisht, nuk mbulon me të ardhura të ligjshme blerjen e pasurive: *apartament banimi në \*\*\* – Kavajë* dhe *autoveturë “Audi”*, për një diferencë negative, deri në datën 16.4.2011, prej – 849.435 lekë<sup>15</sup>.

**22. Vlerësimi mbi mundësitë financiare të subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur me të, për të justifikuar me të ardhura të ligjshme shpenzimet dhe kursimet për vitet 2012 dhe 2015**

22.1 **Komisioneri Publik**, në vlerësim të akteve të administruara në dosje të Komisionit dhe pas analizës financiare të kryer mbi mundësitë financiare të subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur me të, për të mbuluar me të ardhura të ligjshme shpenzimet dhe kursimet për periudhën e deklaramit, konstaton se, përveç problematikave të mësipërme, subjekti i rivlerësimit nuk justifikon me të ardhura të ligjshme shpenzimet dhe kursimet e vitit 2012 (vit kur deklaramet shlyerja pjesore e huas së marrë për apartamentin në \*\*\*, Tiranë) për një diferencë prej – 376.692 lekë, dhe në vitin 2015, për një diferencë prej – 262.928 lekë, në total për një diferencë negative prej – 639.890 lekë<sup>16</sup>.

**23.** Në përfundim, për kriterin e pasurisë, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka mungesë të ardhurash të ligjshme për të justifikuar plotësisht krijimin e pasurive apo kryerjen e shpenzimeve, për periudhën 2003 - 2016, në një total prej – 3.878.744 lekë.

<sup>14</sup> Referohuni vendimeve (JR) nr. 6/2018, prg. 14; nr. 8/2018, prg. 43; nr. 9/2018, prg. 42; nr. 11/2018, prg. 17,17.5 dhe në vijim; nr. 12/2018, prg. 24.11; nr. 5/2019, prg. 23; nr. 10/2018, prg. 67; nr. 19/2019, prg. 22.14.

<sup>15</sup>Në këtë analizë janë përfshirë të ardhurat për periudhën janar 2011- 16.4.2011, të subjektit, sipas vërtetimit të Prokurorisë Durrës, datë \*\*\*.1.2017; të ardhurat e bashkëshortit, sipas shkresës së Drejtorisë Rajonale Tatimore, Tiranë, me nr. \*\*\* prot., datë \*\*\*.11.2019 dhe të ardhurat e pretenduara të arkëtuara në formën e paradhënies dhe shpërblimit nga “\*\*\* \*\*”, person fizik; shpenzimet e jetesës sipas përbërjes familjare për të njëjtën periudhë, shpenzimet për blerjen e pasurive dhe ndryshimet në likuiditetet në llogaritë bankare.

<sup>16</sup> Në të ardhurat e subjektit janë përfshirë të ardhurat sipas vërtetimit të Prokurorisë Durrës, datë \*\*\*.1.2017 dhe të ardhurat nga Universiteti “A. Moisiu”, Durrës; Në të ardhurat e bashkëshortit të subjektit janë përfshirë të ardhurat nga puna pranë “\*\*\* \*\*”, person fizik; nga aktiviteti i subjektit “\*\*\* \*\*”.

Shpenzimet e udhëtimit janë llogaritur bazuar në metodologjinë e përcaktuar nga KPA-ja, sipas jurisprudencës së deritanishme. Shpenzimet e jetesës janë llogaritur bazuar në standardin e përcaktuar nga ILDKPKI-ja, mbështetur në të dhënat INSTAT. Shpenzimet e shkolimit dhe mobilimit janë llogaritur bazuar në deklaramet e subjektit dhe konfirmimeve të institucioneve përgjegjëse. Shlyerja e huas në monedhën euro, në mungesë të dokumentacionit provues, është konvertuar me kursin mesatar të monedhës euro të vitit përkatës.

24. Komisioneri Publik vlerëson se mungesa e të ardhurave të ligjshme për të justifikuar pasurinë, shpenzimet dhe kursimet e deklaruara nga subjekti, e klasifikon atë në kushtet e situatës së parashikuar nga neni D, pikat 1, 3 të aneksit të Kushtetutës dhe neni 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, sipas së cilës, subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarim të pamjaftueshëm dhe të pasaktë për kontrollin e pasurisë.

#### **IV. Kërkimi i ankimit**

25. Nisur nga parashikimi i nenit 179/b, pika 5, të Kushtetutës dhe aneksit të Kushtetutës, konsiderojmë se, ndryshe nga sa disponon Komisioni i Pavarur i Kualifikimit për kriteret e rivlerësimit, duke marrë për bazë gjendjen e fakteve dhe provave në rastin konkret dhe të ligjit të zbatueshëm, Komisioneri Publik ndan gjykim të kundërt, pasi vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk arrin nivel të besueshëm për konfirmimin në detyrë;

26. Duke ritheksuar se Komisioneri Publik ka detyrimin që të ushtrojë kontroll mbi vendimet e dhëna nga Komisioni, me qëllim që të garantojë mbrojtjen e interesit publik në procesin e rivlerësimit, duke vlerësuar në qoftë se vendimmarrja e Komisionit për konfirmimin ose shkarkimin e subjektit, ose ndërprerjen e procesit të rivlerësimit është marrë në përputhje me ligjin, në përfundim të një hetimi të plotë, mbështetur në faktet dhe provat e administruara për këtë qëllim;

27. Bazuar në nenet Ç, D, DH, E dhe F, të aneksit të Kushtetutës, nenin 4 dhe nenin 61, pika 3, të ligjit nr. 84/2016;

28. Komisioneri Publik kërkon, që në zbatim të nenit 66, pika 1, germa “b”, të ligjit nr. 84/2016, në përfundim të shqyrtimit të çështjes në seancë publike, Kolegji të vendosë:

- Ndryshimin e vendimit nr. 275, datë 20.7.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, znj. Enkeleda Osmani (Xhengo).

**KOMISIONERI PUBLIK**

**Florian BALLHYSA**